

PASAPORTA E VOTUESIT

ÇFARË DUHET TË DINI PËR KËTO ZGJEDHJE



25 prill 2021
Zgjidh, Voto, Vendos !



Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



Kingdom of the Netherlands



Botimi është pjesë e projektit ““Forcimi i Transparencës së Zgjedhjeve në Shqipëri” (SETA), I zbatuar nga Akademia e Studimeve Politike në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me mbështetjen e ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë dhe programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri”.”

Opinionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve.

© Copyright ASP 2021



**ÇFARË DUHET TË DINI
PËR KËTO ZGJEDHJE
25 prill 2021**

HYRJE

Zgjedhjet e 25 prillit 2021 do të përcaktojnë deputetët që do të përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve në katër vitet e ardhshme në Kuvendin e Shqipërisë. Njëkohësisht, partia apo koalicioni që fiton nga këto zgjedhje më shumë se gjysmën e mandateve të deputetëve të Kuvendit fiton të drejtën për të krijuar qeverinë që do të drejtojë vendin. Kjo e drejtë u jepet qytetarëve vetëm një herë në katër vite dhe ata duhet ta shfrytëzojnë me përgjegjësinë e duhur këtë mundësi.

Reforma zgjedhore ka përcaktuar ndryshime të rëndësishme në procesin e votimit si dhe ka përfshirë kufizime dhe sanksione të reja për të mundësuar zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Në këtë material informues do të mund të gjeni të detajuar të gjitha risitë e Kodit Zgjedhor me qëllim njohjen e tyre dhe zbatimin e duhur të së drejtës dhe përgjegjësisë për të votuar.



SISTEMI ZGJEDHOR DHE LISTAT E HAPURA

Në këto zgjedhje do të votohet sipas sistemit proporcional me konkurrim rajonal, por duke përcaktuar një prag të ri kombëtar. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar prej 1 përqind të votave.

Vendi është ndarë në 12 zona zgjedhore, që përkojnë me ndarjen territoriale të qarqeve dhe në secilën prej këtyre zonave është përcaktuar një numër i caktuar mandatesh. Numri i deputetëve për çdo qark/ zonë zgjedhore përcaktohet në përpjestim me numrin e banorëve të tij dhe në këtë mënyrë çdo deputet përfaqëson një numër të përafërt qytetarësh në të gjitha qarqet.



Kjo është lista e shpërndarjes së mandateve në qarqe:

Nr.	Qarku/ zona zgjedhore	Mandate
1	Berat	7
2	Dibër	5
3	Durrës	14
4	Elbasan	14
5	Fier	16
6	Gjirokastrë	4
7	Korcë	11
8	Kukës	3
9	Lezhë	7
10	Shkodër	11
11	Tiranë	36
12	Vlorë	12
	Totali	140



Subjekte zgjedhore mund të jenë:

Parti
politike

Koalicion
partish politike
(me një listë
dhe logo të
përbashkët)

Kandidat i
propozuar
nga një grup
votuesish

Subjektet zgjedhore duhet të paraqesin përpara ditës së votimit, një listë shumëemërore të kandidatëve të përcaktuar prej tyre në secilin zonë zgjedhore (qark) të vendit. Në përfundim të votimit, mbi bazën e votave të marra për secilin subjekt, bëhet edhe shpërndarja e mandateve për kandidatët e listës së paraqitur.

Risi – Listat e hapura

Risi në këto zgjedhje është e ashtuquajtura listë e hapur e kandidatëve. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumëemërore. Më konkretisht, renditja e kandidatëve në listën e partisë ndryshon nëse kandidati ka marrë një numër votash parapëlqyese më të madhe se herësi, që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara, por jo më shumë se 10 mijë vota.



Kuota gjinore në lista

Kodi Zgjedhor detyron subjektet që të paktën tridhjetë përqind e listës shumëmemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëëmërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Vakancat e krijuara në rast tërheqje nga mandati duhet të zëvendësohen nga e njëjta gjini. Ky rregull synon që të krijojë mundësinë e përfaqësimit sa më të drejtë të kandidatëve të gjinisë femërore në lista zgjedhore dhe më tej në Kuvend.

E DREJTA E VOTIMIT

Çdo qytetar shqiptar që ka mbushur 18 vjeç deri në ditën e votimit (duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve), ka të drejtë për të votuar e për t'u zgjedhur, pavarësisht nga raca, etniciteti, gjinia, gjuha, bindja politike, besimi fetar, aftësitë fizike, apo kushtet ekonomike.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të dekriminalizimit apo ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, është kufizuar e drejta për t'u zgjedhur dhe votuar për të dënuarit për një sërë veprash penale. Në këto zgjedhje nuk do të mund të kandidojnë dhe votojnë për shkak të këtij ligji 1,098 shtetas të dënuar sipas regjistrimit të fundit.



Autoritet vendore kanë detyrimin që t'ju njoftojnë paraprakisht me shkrim.

Autoritet vendore kanë detyrimin që t'iu njoftojnë paraprakisht në lidhje me qendrën e votimit, vendndodhjen e saj, adresën, si dhe numrin rendor të votuesit në listën e votuesve. Përpara ditës së votimit duhet të siguroheni që emri juaj gjendet në listat e votimit të shpallura publikisht në ambjentet publike pranë njësisë suaj të banimit apo në aplikacionin mobile KQZ Android/IOS, në website www.kqz.gov.al dhe portalit e-albania.

Në rast se ju nuk e gjeni emrin tuaj në listat e publikuara apo identiteti juaj ka pasaktësi, duhet të njoftoni Zyrën e Gjendjes Civile të zonës tuaj. Gjithashtu ju keni të drejtë të paraqisni një kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, **përrjashtohet nga taksat gjyqësore.**



Risi - Identifikimi elektronik

Për herë të parë në Shqipëri do të zbatohet identifikimi elektronik i zgjedhësve. Një pajisje identifikuese elektronike do të vendoset në çdo Qendër Votimi, duke lexuar letërnjoftimin ose pasaportën tuaj.



Pas verifikimit, nënshkrimi do të bëhet duke vendosur shenjë e gishtit në pajisje.

Të dhënat e marra nga pajisja elektronike do të ruhen fizikisht sipas standardeve më të larta të sigurisë. Pas përfundimit të numërimit të votave si dhe përfundimit të afatit të ankesave nga subjektet zgjedhore, të dhënat e votuesve do të asgjësohen. Votimi elektronik do të pilotohet në këto zgjedhje në vetëm një zonë zgjedhore, e cila përkon me njësinë administrative nr. 10 në Tiranë.

Në të gjitha zonat e tjera të votimit në vend do të zbatohet votimi dhe numërimi manual.



PROCEDURAT E REJA NË QENDRËN E VOTIMIT

Qendrat e votimit hapen në orën 7⁰⁰ dhe mbyllen në orën 19⁰⁰. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes së qendrave të votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes.

Si votohet:

- ✓ Paraqisni para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike (kartë identiteti ose pasaportë), i cili skanohet në pajisjen elektronike;
- ✓ Anëtar i komisionit do t'ju timbrosë gishtin e madh të dorës së majtë me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë;
- ✓ Identiteti juaj do verifikohet nga pajisja elektronike brenda qendrës së votimit duke skanuar gjurmën e gishtit të madh të dorës së djathtë. Pajisja do të printojë të dhënat tuaja, të cilat ruhen në një zarf përkatës nga komisioni;
- ✓ Në dhomën e fshehtë përzgjidhet në fletën e votimit subjekti dhe një nga kandidatët e listës së tij duke shënuar shenjën **X** ose **+**, apo një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë, vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij;
- ✓ Fleta e votimit duhet të paloset në mënyrë që të mos dallohet zgjedhja, por vetëm vula në pjesë e pasme të saj;
- ✓ Fleta hidhet në kutinë e votimit.



Kujdes, fotografimi i votës është vepër penale dhe dënohet deri në 3 vite burgim.



Zgjedhësit më aftësi ndryshe

Komisioni i Qendrës së Votimit duhet të sigurojë akses për çdo person me aftësi ndryshe në qendrën e votimit. E drejta e votimit iu garantohet detyrimisht edhe personat me aftësi ndryshe. Në këtë rast zgjedhësi mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.



Risi - Kamera në çdo qendër votimi

Kamera me rezolucion të lartë do të instalohen në çdo qendër votimi. Në rast problematikash ato do të jenë një provë e mëtijshme për garantimin e sigurisë së procesit dhe ndjekjen e incidenteve. Policia gjithashtu është ngarkuar me detyra të mëtijshme për të ndërhyrë në rast të incidenteve të konstatuara gjatë procesit të votimit.



Modeli i fletës së votimit për zonën zgjedhore Berat



QARKU BERAT QV nr. _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
FLETË VOTIMI
Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 23 Prill 2021



1		PARTIA SOCIALDEMOKRATE "PSD" - Tom DOSHI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
2		PARTIA BALLI KOMBËTAR "PBK" - Adriatik ALIMADHI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
3		PARTIA LËVIZJA DEMOKRATIKE SHQIPTARE "PLDSH" - Myslim MURRIZI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
4		PARTIA BINDJA DEMOKRATIKE "BD" - Astrit PATOZI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
5		ALEANCA BASHKIMI POPULLOR "ABEOK" - Kujtim GJUZI Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
6		LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM "LSI" - Monika KRYEMADHI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
7		PARTIA NISMA THURJE "NTH" - Endrit SHABANI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
8		PARTIA LËVIZJA E RE "LRE" - Arian GELDINI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
9		PARTIA DEMOKRATIKE - ALEANCA PËR NDRYSHIM "PD-AN" - Luizim BASHA (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
10		PARTIA ALEANCA DEMOKRACIA E RE "ADR" - Edmond STOJKU	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
11		LËVIZJA PËR NDRYSHIM "LN" - Jozefina TOPALLI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave
12		PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË "PS" - Edi RAMA	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Kandidatit sipas numrave



**ÇFARË DUHET TË DINI
PËR KËTO ZGJEDHJE
25 prill 2021**

KUFIZIMET E PËRDORIMIT TË BURIMEVE SHETËRORE

Që prej 26 dhjetor 2020 kanë nisur efektin e tyre dispozitat e reja të Kodit Zgjedhor, të cilat parashikojnë ndalimin e përdorimit të burimeve shetërore në një periudhë 4 mujore deri në zgjedhjet për Kuvend. Këto kufizime synojnë krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.





Veprimtaritë publike promovuese të zyrtarëve



Mbështetja dhe promovimi nga ana e institucioneve publike, vendore dhe qendrore i projekteve dhe/ose të investimeve të një natyre publike fillimi i të cilëve përkon me periudhën e fushatës zgjedhore dhe që nuk janë lajmëruar paraprakisht (Neni 92, pika 1)



Shpërndarja në veprimtari publike e lejeve të legalizimeve, akteve për regjistrimin e tokës bujqësore apo çdo lloj titulli pronësie tjetër (Neni 92, pika 1)





Aktet ligjore që sjellim përfitime elektorale



- Nisja e propozimeve, aprovimeve ose nxjerrja e akteve ligjore, si dhe akteve nënligjore nga të cilat përfitojnë kategori të caktuara të njerëzve (p.sh. pagat, rritja e pensionit, amnistia fiskale) (Neni 91, pika 4)

Pjesëmarrja në fushatë e administratës shtetërore



- Angazhimi i detyruar i nëpunësve publik/njësive administrative në aktivitetet e fushatës gjatë orarit të punës (shpërndarja e materialeve, pjesëmarrja në takime, puna si staf i fushatës) - (Neni 91, pika 2)
- Përdorimi i detyruar dhe i organizuar i nxënësve të arsimit parauniversitar në aktivitetet e fushatës brenda orarit të mësimi (Neni 91, pika 2)



Emërimet, largimet nga puna



- Premtimi ose ofrimi i përfitimeve për nëpunësit publikë dhe nxënësit e të mirave dhe shërbimeve të blera me fonde publike ose presioni i ushtruar tek ata, për të marrë pjesë në ngjarjet e fushatës jashtë orarit të punës (Neni 91, pika 2)
- Punësimi, pushimi nga puna, kontratat e përkohshme ose afatshkurtra të punësimit gjatë fushatës zgjedhore (Neni 91, pika 3)

Përdorimi i aseteve publike



- Përdorimi i mjediseve të njëjësive administrative /shtetërore pa u privuar, që dhe kandidatëve të tjerë u garantohej përdorimi i këtyre mjediseve në të njëjtat kushte (Neni 91, pika 1)
- Përdorimi i automjeteve (të bashkive /shtetërore) /mjediseve publike për qëllimet e fushatës (Neni 91, pika 1)
- Përdorimi i shërbimeve publike të e-mailit /faqeve të internetit ose promovimi i arritjeve të funksionarëve publikë përmes kanaleve të tjera institucionale të komunikimit (Neni 91, pika 1)



KUFIZIMET PËR FINANCIMIN E FUSHATËS

Financimi i fushatës zgjedhore të partive politike mundësohet nga fonde publike si dhe financime private. **Kodi Zgjedhor përcakton kufizime të reja për financimin e fushatës** së subjekteve zgjedhore si dhe materialeve propagandistike që do të përdoren në këto zgjedhje.

Financimi i subjekteve nga fondet publike (Neni 86)

- Përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj.

Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike (Neni 92/1)

- Financimi privat nuk mund të kalojë vlerën e trefshit të fondeve publike të dhëna. Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlera në sende ose shërbime. Konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



**Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik
apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga
kushtet e mëposhtme:**



- a. Ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 3 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë.



- b. Ushtron veprimtari në fushën e medias;



- c. Ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;



- d. Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.



- Personat fizikë ose personat juridikë, që i kanë bërë dhurime një subjekti zgjedhor apo kandidatëve të tij në zgjedhje, nuk mund të përfitojnë për periudhën deri 3 vjet pas datës së zgjedhjeve kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën prej 10 milionë lekësh, përfshirë edhe si nënkontraktues të një kontrate/koncesioni publik.



Gjithashtu janë përcaktuar kufizimet e mëposhtme për organizimin e fushatës zgjedhore

NDALOHET



- Ofrimi nga subjektet zgjedhore i parave, të mirave material, premtimi për vende pune ose favore të tjera votuesve, me synim marrjen e nënshkrimit për kandidim, për të votuar në një mënyrë të caktuar ose për të marrë pjesë ose jo në votim (Neni 78, pika 7)



- Zhvillimi i fushatës zgjedhore në një institucion publik (Neni 78, pika 6)
- Organizimi apo mbulimi i shpenzimeve për koncerte, evente kulturore apo argëtuese apo bamirësie nga subjekti zgjedhor/kandidati (Neni 78, pika 9)
- Ofrimi nga subjekti zgjedhor/kandidati i artikujve ose materialeve të printuara me vlerë prej më shumë se 500 lekë për artikull (Neni 78, pika 10)
- Vendosja e materialeve propagandistike statike (postera, flamurë etj) më larg se pesë metra nga zyrat elektorale (Neni 79, pika 2)
- Ngritja e zyrave zgjedhore të subjekteve në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve. (neni 5, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 i KQZ)
- Mospërfshirja në materialet vizive propagandistike e deklaratës së autorizimit me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (Neni 79, pika 2)



PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

Pjesëmarrja në zgjedhje është një e drejtë, por njëkohësisht për bën edhe një përgjegjësi. Nëse zgjedhësit shkelin detyrimet apo bëhen pjesë e veprimeve, të cilat synojnë shtrembërimin e rezultatit të zgjedhjeve, atëherë ata rrezikojnë që të bëhen subjekt i ndëshkimeve të parashikuara si më poshtë vijon:

- Pengimi me çdo mënyrë i subjekteve zgjedhore apo kandidatëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**



- Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit me qëllim ndryshmin e rezultatit të zgjedhjeve, ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Kur falsifikimi kryhet nga persona që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor dhe shoqërohet me pasoja të rënda. **DENOHET NGA 3 - 7 VITE BURG**
- Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje i çdo materiali tjetër zgjedhor - **DENOHET NGA 6 MUAJ - 5 VITE BURG**
- Kur dëmtimi kryhet nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim dhe ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve - **DENOHET NGA 3 - 8 VITE BURG**
- Fotografimi apo filmimi i votës, që ta shfaqësh tek persona të tjerë. **DENOHET NGA 3 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Kur shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit kryhet nga personat e ngarkuar me zgjedhjet. **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Nxitja, detyrimi me ose pa shpërblim i zgjedhësit për të shkelur rregullat që garantojnë fshehtësinë e votimit. **DENOHET NGA 1 - 4 VITE BURG**



- Votimi më shumë se një herë, me mjete identifikimi të rreme apo të zgjedhësve të tjerë. **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Lejimi me dashje i votimit më shumë se një herë nga komisionerët zgjedhorë. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit. **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Kërkimi ose pranimi nga zgjedhësi i të hollave, të mirave materiale, ose favorizimeve të tjera për të marrë pjesë ose jo në votime. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime. **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Kur kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër në kryerjen e detyrës. **DENOHET NGA 1 - 4 VITE BURG**
- Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë. **DENOHET NGA 2 - 5 VITE BURG**



- Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, duke shkelur rregullat e votimit. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë. **DENOHET NGA 3 - 7 VITE BURG**
- Dhënia e dokumentit të identifikimit personave të tjerë për të votuar . **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Marrja e dokumentit të identifikimit shtetasve të tjerë për të ndikuar në votim me qëllime të paligjshme. **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Pjesëmarrja e një punonjësi të administratës shtetërore në aktivitete ose fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Detyrimi ose organizimi i nxënësve të arsimit parauniversitar për të marrë pjesë në fushatë nga punonjës në arsimin publik dhe jopublik **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Detyrimi ose kërkesa nga punonjës që kryen një detyrë shtetërore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore, ose për të votuar në një mënyrë caktuar **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**



- Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një subjekti zgjedhor. **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Shpërdorimi i autoritetit ushtarak për të influencuar në votime tek ushtarakët e tjerë me dhënie urdhërash, apo çdo propagande tek vartësit. **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Shpërdorimi i autoritetit policor nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose i Policisë së Burgjeve për të influencuar në votime me dhënien e urdhrave, apo çdo propagande tek vartësit. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**





Nëse konstatoni shkeljet e mësipërme mos hezitoni të denonconi pranë portalit të denoncimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor në adresën **<http://kqz.gov.al/kallzo>** ose nëpërmjet aplikacionit mobile KQZ për telefonat smartphone. Mund të zgjidhni të mbeteni anonim, por denoncimi do të shqyrtohet në rast se e keni shprehur sa më qartë dhe me të dhëna.

Denoncimet tuaja do të ndiqen më pas nga organet e drejtësisë, mes të cilave edhe Prokuroria e Posaqme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Për më shumë informacion kontaktoni:
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



www.kqz.gov.al



info@kqz.gov.al



A e dini se ?

Zgjedhjet e para përfaqësuese në Shqipëri për kriimin e parlamentit kombëtar konsiderohen ato të Marsit 1921, për mandatimin e Këshilli Kombëtar të krijuar nga Kongresi i Lushnjës. Në këtë rast votimi ishte nëpërmjet delegatëve të çdo krahine.

Gratë fituan të drejtën e votës në Shqipëri në zgjedhjet e para pas Luftës së Dytë Botërore më 2 dhjetor 1945.

Më 22 Mars 1992 u mbajtën zgjedhjet e para të njohura si plotësisht pluraliste të historisë moderne të Shqipërisë.

Zgjidh, Voto, Vendos !



